


Fillimi > -Kronikë

VIDEO/ Sekuestrohen 29 kallëpe me eksploziv dhe 15 kapsolla detonatore në Durrës, në pranga dy kuksianët, do i shisnin për 12 mijë euro

05 Janar, 2021 15:20 | 2 567 shfletime



Madhësia e tekstit: - +



DURRËS



29 kallëpe me eksploziv me peshë 18 kg dhe 15 kapsolla detonatore janë sekuestruar në Durrës.



Në pranga kanë rënë dy poseduesit nga Kukësi, teksa zbulohet se do i shisnin në total për 12 mijë euro.



Dy poseduesit po udhëtonin drejt Durrësit me automjet dhe lëndën eksplozive si dhe kapsollat detonatorë i kishin vendosur në bagazh.



NJOFTIMI NGA POLICIA

Durrës

Finalizohet me sukses operacioni i koduar “Trajektorja”.

Operacioni i zhvilluar nga shërbimet e Komisarariatit të Policisë Durrës.

Sekuestrohen 29 kallëpe me lëndë eksplozive me peshë 18 kg dhe 15 kapsolla detonatore.

Arrestohen në flagrancë 2 poseduesit e lëndës eksplozive, të cilët do e shisnin atë kundrejt vlerës 12.000 euro.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Durrës, në vijim të punës për goditjen e paligjshmërisë, kapjen e personave që lëvizin me sende të kundërligjshme dhe rritjen e parametrave të sigurisë në qytet, në bazë të informacioneve të siguruara nga Seksioni për Hetimin e Krimeve, organizuan punën dhe finalizuan me sukses operacionin policor të koduar “Trajektorja “, në kuadër të të cilit u arrestuan në flagrancë shtetasit:

B.B., 42 vjeç dhe Sh. T., 31 vjeç, banues në Kukës.

Shërbimet e Policisë, pas informacionit të siguruar se në drejtim të Durrësit po lëvizte një automjet me 2 persona, të cilët kishin vendosur në bagazh një sasi të konsiderueshme lënde eksplozive, menjëherë kanë organizuar punën dhe në Sukth kanë ndaluar mjetin me të cilin po lëviznin shtetasit B. B. dhe Sh. T. Pas kontrollit të ushtruar në bagazhin e mjetit janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale 29 kallëpe me lëndë eksplozive, me peshë 18 kg, si dhe 15 kapsolla detonatore, të cilat këta shtetas do t'i shisnin kundrejt vlerës 12.000 euro.

Nën drejtimin e Prokurorisë vijon puna për identifikimin dhe kapjen e personave të tjerë të implikuar në këtë veprimtari kriminale.

Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për veprime të mëtejshme.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: Durrës eksploziv kallepe kukës

TË NGJASHME

U kap me 2 kg fara kanabisi, pranga 37-vjeçarit në Durrës

09 Janar, 2021

VIDEO/ Reshjet shkaktojnë përmbetje në Durrës, problematike situata në lagjet periferike

08 Janar, 2021

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Gjuetari shkon në pyll për të gjuajtur derra të egër, qëllon aksidentalisht veten

09 Janar, 2021

“Shqiptarët duhet të qëllohen dhe të vriten”, 5 oficerë policie në Angli shkarkohen pas komenteve raciste e seksiste

09 Janar, 2021

Merr flakë në ecje makina në aksin Korçë-Pogradec, shpëton mrekullisht shoferi. Sihni pamjet e frikshme (Video)

09 Janar, 2021

“Prurjet sollën dru e gurë”, lumi Mat ndan në mes urën e Skurajve, izolohen 200 banorë

Enver Doçi | 09 Janar, 2021

Tragjedia e 9 janarit në Karaburun, familjarët e viktimave: Kemi humbur shpresën te drejtësia

09 Janar, 2021

“I ka kontrolluar tërë vendet që mbollën”, përgjimet për grupin e drogës në Skrapar, si grabitej kanabisi në kohën e korrjes, rolet e të akuzuarve

09 Janar, 2021

KATEGORIA VIDEO

“Prurjet sollën dru e gurë”, lumi Mat ndan në mes urën e Skurajve, izolohen 200 banorë

Enver Doçi | 09 Janar, 2021

Tragjedia e 9 janarit në Karaburun, familjarët e viktimave: Kemi humbur shpresën te drejtësia

09 Janar, 2021

Kampioni European i Gjinnastikës, rusi me pasaportë shqiptare viziton palestren e gjinnastikës në Berat

09 Janar, 2021

Rama s'i ndal ironitë për PD: 'Vizitë për kujtimore' në Gjanicë, paguam dhe shpronësimet për tokat e 'xanuna' të Shabës

09 Janar, 2021

“Tendenca në rritje të rasteve me COVID"/ Tomini: Jemi larg imunitetit të tufës. Mutacion i ri në Shqipëri?! Deri tani asnjë rast!

09 Janar, 2021

SPECIALE/ “Lista e Salihut”, MEDvegja drejt shpopullimit, shqiptarëve u fshihen adresat

Fatmira Nikolli | 09 Janar, 2021